

## INTERVISTË ME LIRIJE BULIQIN

Prishtinë | Data: 19 dhjetor, 2020

Kohëzgjatja: 78 minuta

Të pranishëm:

1. Lirije Buliqi (E intervistuar)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Fitim Shala (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Erëmirë Krasniqi:** A mundesh me na tregu kur keni lind, edhe lagjen, vendin?

**Lirije Buliqi:** Une jom lind në vitin 1955, në Pejë, në lagjen Puhovc. Puhovci atëherë ka qenë prej lagjeve që është konsideru ma e civilizume, edhe pse kushtet i kemi pasë katastrofë. Për shembull, në familje kemi qenë gjashtë fëmijë, jeta ka qenë asisoji që krejt fëmijët e mahallës kemi lujt bashkë. Në shpi kërkush s'ka pasë lodra. Atëhere kemi lujt me rrota të kerreve të thyme, kem lujt me kapitasha. Pra, një fëmini që ka qenë shumë e shëndoshë, shumë bukur kemi kalu. Une gjithmonë jom përzi, në shoqni kom ndejt ma shumë me djem, se vajza s'ka pasë shumë në atë periudhë kur jom lindë une.

Ka qenë një kohë që nuk harrohet kurrë. Edhe ato lodrat me të cilat kemi lujt, kukllat që jemi mundu me i mbaru, i kemi mbaru prej ceremideve. I kemi ngjyrosë kukllat ose i marojshim me vek, sepse shumë prej grave janë marrë me vek, kanë punu me vek qylyma, sexhade, e këto. Domethonë, prej këtyne sendeve jemi mundu me lujt, me kriju figura të lodrave. Në atë periudhë që të gjithë kemi qenë në atë nivel, njëfarë varfnie ka qenë atëhere.

Rrugët kanë qenë të paasflatume, sa rrishim jashtë t'u lujt, kur shkojshim në shpi u dufke m'u la, se të papastërt u kthejshim. Por, ka qenë një mahallë e dendun, plot gjallni, plot lumturi kena pasë. Tana prej... s'kisha veçu shumë, e kem pasë atë lagje ku jom rritë, u konë Bistrica, e krejt gjatë verës, krejt fëmitë qaty tonë kohën e kalojshim, tjetër s'po di çka kisha thonë për fëmini.

**Erëmirë Krasniqi:** Përmende edhe vekun, a është marrë nana jote?

**Lirije Buliqi:** Nana jeme është marrë me vek, edhe une si fëmi gjithmonë kom qenë afër saj, e kom marrë edhe zanatin edhe i kom ndihmu pak a shumë me diçka. Me këtë janë marrë shumica e grave, ato kanë punu qylyma, sexhade.

**Erëmirë Krasniqi:** A jane bo ato për nevoja personale, apo si ka qenë?

**Lirije Buliqi:** Jo, faktikisht puna me vek ka qenë ma shumë për ekzistencë, se shumica s’kanë punu në organizata të shtetit, s’kanë pasë punë atëhere. Kjo ka qenë për ndihmesë pak edhe nana që është angazhu se gjashtë fëmijë kemi qenë, gjashtë fëmijë janë shkollu. Pra, kjo ka qenë për ekzistencë.

**Erëmirë Krasniqi:** E baba çka ka bo?

**Lirije Buliqi:** Baba ka vdekë i ri, domethonë pesë vjeç... mu shumë pak më kujtohet. Atëherë nana është marrë tonë kohën me ne. Edhe na ka shkollu...

**Erëmirë Krasniqi:** Çka mundesh me kallxu ma shumë për edukimin?

**Lirije Buliqi:** Shkollën fillore e kom kry në... atëherë është qujt “Boris Vukmirović”, domethonë aty kom fillu edhe tetëvjeçaren e kom kry qaty domethonë.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ka qenë?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë shkollë tepër e vjetër, bankat shkollore, normal që kanë qenë shumë të vjetra. Kom qenë nxanëse e shkëlqyshme, deri në klasën e katërt, tani prej të katërtës, në të pestën klasë është dashtë serbishtën me mësu, serbo-kroatishte ka qenë atëhere, edhe një gjuhë të huaj që ka qenë rusishtja. Domethonë, dy gjuhë sllave i kemi pasë, që shumë vështirë i kemi mësu. E kemi pasë... për shembull, kur kishim gjuhë serbo-kroate, çirilicën e kemi mësu për serbisht. Libra s’kemi pasë sikur tash që i kanë të gjitha librat. Ne s’kemi pasë libra, me libra të vjetra, klasat që e kryshin klasën e parë na jepshin neve. Domethonë, u përcillshin librat e vjetra.

Serbisht kur kishim, për shembull na diktojke arsimtari, na fjalët nuk i kuptojshim amo shkrujshim. Për shembull, veç një detaj që më kanë lënë përshtypje që nuk e harroj kurrë, kishim diktim, po thotë, “Pikë - *tačka*” na po e shkrujmë me fjalë *t-a-č-k-a*. Pra, s’kemi ditë as çka po shkrujmë, s’kemi kuptu. Por me kohë, dy-tri vjet jonë bo tani edhe gjuhën ruse që e mësum edhe ajo që na ka dhonë ka qenë serbe. Nuk kuptojshim në asnjë mënyrë, as rusishtën, as serbishtën, por mirë u mësum, e mësum normal.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë shoqnie ka qenë ajo në Pejë, a ka qenë e përzime apo?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë e përzime. Në atë rreth që jemi rritë kemi pasë të Malit të Zi kojshi, pak a shumë e kom ditë gjuhën, e kemi pasë ne atë mënyrën si jemi kuptu. Ka qenë shoqni krejt ndryshe prej kësaj sot, domethonë bashkë kemi qenë në çdo lojë. Çdo kohë të lirë që e kemi pasë kemi dalë në rrugë me lujt, kemi qenë bashkë, s’ka pasë diferencë që është serb a diçka. Jo, krejt kemi qenë një.

**Erëmirë Krasniqi:** A keni shku në patriarshi?

**Lirije Buliqi:** Shkojshim po edhe në patriarshi, shkojshim u mledhshim, po na kur shkojshim, shkojshim fëmitë e krejt mahallës për shembull. E atje bojshim zhurmë, se si fëmijë që ishim, lujsim. Ka ndodhë që edhe na kanë përzënë (qesh) prej kishës.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju kujtohen ato afreskat që kanë qenë aty?

**Lirije Buliqi:** Afreskat, kështu shumë mrenda s'kena hi se na, ma shumë kena shku me luft, u konë ni dud atje edhe krejt mas dudit shkojshim, qato na përzejshin. E kështu jo që s'kishim, se çdo shpi atëherë kena pasë pemë nëpër shpija se u konë ajo pjesa ka Bistrica, çdo shpi' ka pasë bashqë, veç na tërheke ma shumë me shku atje. Edhe bile kena fillu masi kena... kur e regjistрова gjimnazin, edhe si gjimnaziste kena shku atje edhe shkojshim... amo profesorat na çojshin atëherë. Për shembull, vizatim kur kishim, art figurativ shkojshim në kishë, patriarshi edhe vizatojshim, ja kambanat, ja atë shtëpizën ku ata flejshin, ose dudin, domethonë ndonji pjesë që na tërheke ma shumë.

**Erëmirë Krasniqi:** Aq piktoresk ka qenë gjithë ai ambient?

**Lirije Buliqi:** Po, ka qenë. Ka qenë hapsina shumë e madhe, oborri i madh.

**Erëmirë Krasniqi:** E në Rugovë, a shkojshit?

**Lirije Buliqi:** Në Rugovë, jo, larg. Ajo larg ka qenë, atëherë s'kena pasë kerre si tash, jo. Atëherë, si fëmi lujsim qesi kerre me kuaj që ka pasë për shembull, si fëmijë shkojshim mas tyne t'u luft si çdo fëmijë tjetër që i tërhek diçka çka s'e ki në shpi.

**Erëmirë Krasniqi:** Po s'ka pasë vetura në atë kohë.

**Lirije Buliqi:** Ka pasë shumë pak, tepër pak ka pasë. Edhe ata kur vishin, ma shumë si turista kur vishin, se në përgjithësi s'ka pasë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë Peja turista?

**Lirije Buliqi:** Ishin në patriarshi që vishin ma shumë.

**Erëmirë Krasniqi:** Domethonë, qajo osht' edhe njifarë lloj ekspozimi.

**Lirije Buliqi:** Qajo ka qenë, po. Ose shkojshim për Mal të Zi, amo rrugët kanë qenë katastrofë.

**Erëmirë Krasniqi:** Ok, ti e përmende që edhe gjimnazin e ke kry në Pejë.

**Lirije Buliqi:** Gjimnazin "11 Maji" në Pejë e kom kry, po.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ka qenë kjo periudhë, a mundeni pak ma shumë me na tregu?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë, qysh jemi pranë me rezultat të shkollës fillore. Në provim pranë...

**Erëmirë Krasniqi:** Çka mësojshit? Çka... çka kanë qenë ato mësimet të cilat në njëfarë forme ju kanë përgadit për ma tutje?

**Lirije Buliqi:** Atëherë s'ka pasë kesi përgaditje tash që paraprakisht bohen, po qysh e ke pasë inteligjencën (qesh), vet qysh e ke pasë. Po mendoj, as prindi s'ka mujt me të mësu, se s'kanë qenë të shkollum. Në atë kohë, nona jeme edhe shoqet tjera si nona jeme s'kanë pasë shkollë, s'kanë kry asni shkollë. Kena... une kom mësu, se vllaznit i kom pasë ma të mëdhej ata kanë kry, domethonë ata i kom pasë ndihmesë prej tyne. Edhe ata e kanë kry shkollën e mesme, njeni e ka kry bile në Kragujevc.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ka qenë Peja gjatë kësaj periudhe që ke qenë në shkollë të mesme, çfarë qyteti, a përparojke a, a ka ndodhë najçka?

**Lirije Buliqi:** Faktikisht edhe qat' periudhë kurgjo s'ka përparu. Kryesisht është ndërtu vetëm qendra e Pejës, e rrugët kanë mbetë... po mendoj gjatë, gjatë shkollës mesme atëhere kanë fillu veç me e asfaltu edhe pjesën na ku ishim, domethonë ajo pjesë.

**Erëmirë Krasniqi:** Në cilat vite?

**Lirije Buliqi:** Vitet jonë konë... eh tash s'po më kujtohet si fëmijë viti '68, e di që policia vike në kojshi. Domethonë, ka qenë një i dënum politikisht që ka qenë... flamuri kur e kanë...

**Erëmirë Krasniqi:** Ngritë.

**Lirije Buliqi:** Ngritë, po. Domethonë, ka qenë, ka nejt disa vite i burgosun, tana është liru, por çdo vit me datë të caktume kanë ardhë e kanë malltretu çdo vit, domethonë në Bisticë. E di si fëmijë që kur vishin, shkojshim te Bistrica e ato e malltretojshin. Me durë të lidhne, e temperatura të ulëta kanë qenë, dimën, e malltretojshin atë person.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë nëntor a, rreth festës flamurit a?

**Lirije Buliqi:** Po, rreth festës flamurit qashtu po edhe kur ju bike në mend për diçka, domethonë ka qenë vazhdimisht i malltretum.

**Erëmirë Krasniqi:** A ndodhke kjo edhe me njerëz tjerë apo?

**Lirije Buliqi:** Me tjerë s'e di, po në atë pjesë ku jom rritë, atë rast e kemi ditë të gjithë.

**Erëmirë Krasniqi:** Përmende që në të '60-tat ka fillu njifarë zhvillimi i qytetit, çfare ka qenë deri në atë moment, a ka qenë ma shumë ashtu qytet oriental?

**Lirije Buliqi:** Qyteti, për shembull, ujin nëpër shpi s'e kena pasë, kroni u konë në një mahallë. Krejt mahalla qaty shkojke me mbushë ujë, përndryshe e kena pasë Bistricën për sende tjera.

**Erëmirë Krasniqi:** E shpijat çfare kanë qenë?

**Lirije Buliqi:** Shpijat kanë qenë të ulëta, të vogla. Ka një dhomë, dy dhoma eventualisht që jonë konë. Shumë të vogla kanë qenë shpijat, edhe ato të marume jo me material të mirë, me material shumë të butë, po mendoj jo adekuat për banesë, për banim. Po veç, qysh me thonë, kemi qenë të lumtun, pavarësisht situatës, në ato kushte që jena rritë prapë një lumturi e kena pasë. Domethonë, ni shoqni e shnoshë, u ndihmojshim me mësim, me krejt çka kishim nevojë një për tjetrin jonë konë gjithë të përgaditun të gatshëm për me ndihmu.

**Erëmirë Krasniqi:** E tani mandej kur filloi ndërtimi i qytetit, urbanizimi...

**Lirije Buliqi:** Kjo pjesë jo, atëherë veç fillun se thashë, e ceka edhe ma përpara ka pasë shumë malazezë në kojshi. Atëherë, ata fillun jo në Mal të Zi me shku, jo në Serbi. Domethonë, shumica, u ndrru struktura e banorëve në atë pjesë ku jom rritë. Tanaj vishin, popullata shqiptare vishin prej fshatrave të ndryshme edhe u mbushë ajo, domethonë që u ndërtu një pjesë e rrugëve ku ka qenë qaty, u asfaltun edhe fillun do shtëpia të reja me u ndërtu. Domethonë, në atë pjesë une ku jom rritë, qekjo pjesë nuk është zhvillu ma tepër veç është shtu një pjesë e rrugës, është ngushtu edhe kanë marru shpija të reja.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh vendosët me ardhë në Prishtinë me studiu?

**Lirije Buliqi:** Po une kom qenë... nejsje atje s'ka pasë shumë... Për Prishtinë, kur e kryva gjimnazin erdha në studime në, në juridik. Edhe fillova me... po mendoj i kryva dy vite mbetën edhe...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh vendose kallxom nihere?

**Lirije Buliqi:** Vendosa se vllau ka studiu në Zagreb, e dëshira jeme ka qenë me studiu edhe une psikologjinë, më ka pëlqy shumë si landë në shkollë të mesme, po kushtet ishin pak ma të vështira edhe vllau ma shumë ishte që ndikoi në vendimin tim. Tha se atje e ka ndi veten shumë të nënçmume, të nënçmum, në Zagreb. E kështu që vendosa prapë në Prishtinë edhe në Prishtinë juridik e regjistrova

me provim pranus. Edhe na si, si gjimnazista që ishim, gjimnazin që e kishim kry shumë kam qenë, e kemi pasë ni përparësi.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Lirije Buliqi:** E regjistrimi u bo na si gjimnazista, po menoj prej shkollës gjimnazit jem konë ma të veçum, kem pasë përparësi edhe në pranim, në provim pranus. Se kriteri ka qenë krejt tjetër në gjimnaz, domethonë shumë ka qenë... nxanësit jonë konë të disiplinum, kem pasë uniforma, pa uniformë s'ke mujt në shkollë me hi. Nxanësit që kanë mungu kanë qenë ose të... osht' njoftu, prindi osht' thirrë që me u marrë me te, përndryshe u përjashtojshë prej shkollës.

**Erëmirë Krasniqi:** A të pëlqejke kjo disiplinë?

**Lirije Buliqi:** Mu s'më ka pengu aspak, se unë jom konë pak si fëmijë... tana veç kur u rrita ma e tërhekme jom konë, kom qenë e interesume ma shumë me mësu edhe kështu që e kryva me sukses gjimnazin edhe mbeta tash me studiu, ku? Mendimi im ka qenë, vullneti im ka qenë në Zagreb, po nuk o realizu. Kështu që, u orinetova prapë në juridik.

**Erëmirë Krasniqi:** A ke vendim krejt i joti, a qysh?

**Lirije Buliqi:** Ke pak ndikimi, vllau ndikoi. Jo nashta edhe materialisht s'kom pasë kushte, po ka qenë kushti që ai si student në Kroaci si duket ka pasë, ka përjetu qesi nënçmime prej shqonisë, prej kolegëve të tij, e kështu që më bindi për me shku në Prishtinë edhe me studiu çka dëshiroj vet. Edhe kështu vendosa në juridik, se zakonisht krejt klasa kemi qenë shoqni shumë e mirë, krejt klasa vendosi po shkojmë në juridik, krejt shkumë në juridik. Tash dikush kryjti, dikush s'kryjti. Une, nejse në ndërkohë u punësova në Galeri, e në momentin që u punësova filloi me më pëlqy tash arti. Edhe pse në shkollë të mesme kom pasë talent, sidomos në kolazh edhe kom pasë notë, pesëshe e kom pasë. Po s'jom konë e interesume, s'kom mendu kurrë që vi me studiu artin.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë artistë në atë kohë, në qytetin e ju?

**Lirije Buliqi:** Ka pasë...

**Erëmirë Krasniqi:** Që e keni kuptu çka osht'...

**Lirije Buliqi:** Ka qenë Shkolla e Mesme e Artit, po kurrë une s'kom mendu.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë... Shkolla e Artit ka pasë nam të madh, a e ka afektu edhe qytetin?

**Lirije Buliqi:** Jo, shumë çudi. Në Pejë jo shumë. Krejt kanë ardhë prej qyteteve tjera Gjakova, Prishtina, Prizreni kanë kry në Pejë, prej pejonve ma pak. Veç unë tash as ondërr se kom pasë që kom me punu në Galeri.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ndodhi që aplikove për punë në Galeri?

**Lirije Buliqi:** Ndodhi se tash dy vite i kryva, të tretin e regjistrova edhe vendosa m'u punësu, e pash ni konkurs që ish publiku në gazetën "Rilindja" u konë, aplikova, u pranova edhe fillova në vitin '80.

**Erëmirë Krasniqi:** Kush ishte në atë kohë në Galeri?

**Lirije Buliqi:** Në Galeri kur kam qenë takimi i parë me person ka qenë, i ndjeri Engjëll Berisha.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë roli ka pasë ai në atë kohë në Galeri?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë bashkëpunëtor.

**Erëmirë Krasniqi:** I jashtëm?

**Lirije Buliqi:** Jo, i brendshëm. Atëherë jonë konë titujt tjera, kustos ka qenë, e me to kom kontaktu, takimi i parë. Masanena u bo kjo, provimi pranus, provimi kësi, i konkursit, vlerësus edhe une prej... shumë ka pasë kandidatë, kem pasë provim, atëhere ka qenë dy-gjuhësia, serbo-kroate gjithqysh osht' dashtë, ka qenë kusht për me u pranu. E kem pasë landën pak me përkthi shqip, të kundërtën edhe fillova me 1 prill në Galeri.

**Erëmirë Krasniqi:** A dishit ju për Galerinë, a ka qenë...

**Lirije Buliqi:** Si Galeri ka qenë... jo, as s'kom ditë me çka merret ajo Galeri, nuk kom ditë programin çka osht' Galeria si institucion, se s'kena pasë përpara Galeri që ke shku me vizitu. Si studente kom shku, përveç teatrit diçka tjetër s'mbaj mend që ka pasë.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Lirije Buliqi:** Si studente u vendosa në *dom* [serbisht - konvikt], domethonë në qendrën studentore, në qendrën *dom*, me tri shoqe, cimere. Ditën e parë kur kemi dalë, domethonë për mu u konë qytet i panjoftun. Kjo prej stacionit deri te menza e studentëve (qesh) që u takojshim aty krejt grupi, ka qenë krejt livadh kjo pjesë, Dardania. Domethonë, deri në qendër, kena ecë bajagi për me mrrri deri në qendër.

**Erëmirë Krasniqi:** Ku ka qenë qendra atëhere, te "Grandi", a në qytet të vjetër?



**Lirije Buliqi:** Te “Grandi”. Aty u takojshim edhe në korzë dilshim, domethonë në mbramje u konë si obligative, shpejt e shpejt m’u bo gati me dalë në korzë. Në korzë ish vetëm shetitore, veç u sillshim qaty (qesh), e kalojshim. E për kështu, aktivitete e di që kena shku për herë të parë kam shku në teatër.

**Erëmirë Krasniqi:** Kur jeni ardhë në Prishtinë?

**Lirije Buliqi:** Në Prishtinë, po. Tash s’po më kujtohet ç’a kom kqyr herën e parë veç e kom ndi një knaqësi, një, një, tamam që kom ardhë me ni qytet ma të madh se ku jom rritë.

**Erëmirë Krasniqi:** Gjithmonë me këta të shkollës mesme, a...

**Lirije Buliqi:** Krejt të shkollës mesme i kom pasë shoqinë, po ndërkohë tana u takum edhe me do shoqe, u zgjanu shoqnia tana. Gjakovare kom pasë shumë, kom pasë të Prizrenit shumë, kom pasë edhe cimere të Prizrenit, kem kalu shumë mirë, kem gjetë gjuhë të përbashkët, si me mësu... për me mësu tash ishim pak ma problem, dikush msojke ma shumë, dikush ma pak. Po u dufke m’u çu në mëngjes herët kush dojke me mësu, me shku në bibliotekë. E biblioteka atëhere ka qenë tash që është Galeria Kombëtare. Msojshim ka dy-tri orë, ligjeratat jonë konë obligative edhe pse disa landë, disa landë i mbajshim në amfiteatrin e madh juridik, aty nja 300 vet jena konë me siguri.

Na, tash po foli për veti, shoqnia jeme që jena konë, nja pesë-gjashtë veta jena konë. Këta që msojshin ma shumë shkojshin në rreshtat e para për me ndëgju ma mirë ligjerata. E na shkojshim në rreshtin e fundit, ishim të parët për me nxonë vendin e fundit (qesh). Ka qenë... kështu që... po mendoj ke mësu sa ke mujt me mësu, ligjerata osht’, ka qenë një përvojë që je përgadit pak në lidhje me çka është landa edhe pse kishim edhe libra pak mungesë, domethonë s’kena pas literaturë ku me dit çfare, po edhe ato që i kishim, shumë nuk, nuk u msojke.

**Erëmirë Krasniqi:** E profesorat a ishin të ktuhit, a të Beogradit, prej kahit kanë qenë?

**Lirije Buliqi:** Jo, profesorat kanë qenë të Maqedonisë, e di që kanë qenë edhe të ktuhit kanë qenë kryesisht.

**Erëmirë Krasniqi:** Edhe literatura që qarkullojke...

**Lirije Buliqi:** Shqip ka pasë, shqip e kena pasë me mësu. Po mendoj qato landë që ma shumë u dufke, tjerat i kena pasë kështu me të ndëgjume, u gjindshim sërabisht me lexu ndonji libër, që e gjojke dikush, tanaj u përcillke ai libër. Po kush ka dashtë me mësu, ka mujt me arritë, po mendoj me kry me kohë edhe pse une e kom pasë ni shok të klasës ai u konë në gjimnaz tepër i dobët, kur erdh këtu merrke nota të nalta (qesh). A din, për neve u konë diqysh si... na që e njifshim... ai e kryjti me kohë, une mbeta u punësova, kështu që disa e kanë kry, disa kanë mbetë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë “Elida” atëhere?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë, po.

**Erëmirë Krasniqi:** Afër Galerisë?

**Lirije Buliqi:** “Elida”... Çka më ka lënë përshtypje ma së shumti, une në “Elidë” kom qenë kur kom e pa për herë të parë konkursin. Në “Elidë” e kom shkrua kërkesën edhe kur kom dalë prej aty t’u mendu kujt me iu drejtu me pyetë për me më tregu ku është Galeria, se domethonë sa ishte hapë edhe nuk e dishim. Kur kom dalë prej “Elidës” veç rastësisht po kqyri çfarë shitore ka ngjitur me “Elidë”, se atëherë ka qenë në qendrën tregtare në “Boro dhe Ramizi”, kur po e shoh Galerinë. Edhe aty hina edhe kontakti i parë ka qenë me Engjëll Berishën, që e dorëzova aplikacionin edhe më lajmrun për konkurs edhe për testin. Më kishin caktu mu ma të mirën edhe fillova me punu.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ka qenë dita e parë?

**Lirije Buliqi:** Dita e parë ka qenë... salla ekspozuese ka qenë shumë e madhe. Atëhere, bash te hymja në anën e djathtë më kujtohet një sallë shumë e madhe, thashë, “Çka bohet këtu?” {ngrit supet} Ka qenë në ekspozitë aty e kanë qenë punimet e vendosura, se për mu...

**Erëmirë Krasniqi:** Cila ka qenë ekspozita në momentin kur je kyç?

**Lirije Buliqi:** E... {vendos syzet shikon diçka poshtë} ka qenë ekspozita “Padova pararomake” {heq syzet}.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë objekte, a t’u dokshin interesant?

**Lirije Buliqi:** Tash unë nihere, ma shumë isha e koncentruar në zyre, domethonë krejt punët që i kom pasë në zyre. Për ekspozita kur është bo pranimi i veprave për shembull, u pregaditke materiali për pranim, domethonë atëhere përmes doganës normal që kanë shku, po u konë edhe shpedicioni përpara, me shpediter i bibe deri në Galeri. Domethonë, u konë pak ma e thjeshtë procedura e doganimit. Tani, ne jse, u instalojke punimi edhe kem qenë një ekipë shumë e vogël, prej gjashtë vetave jena konë, e të gjithë u kyçshim.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë profili?

**Lirije Buliqi:** Kem pasë, kurgjo, kem pasë drejtori u konë Shyqri Nimani, Engjëll Berisha u konë kustos, e kem pasë kontabilistin, e kem... kom qenë une, teknik kem pasë Rrahmanin edhe një pastrus. Domethonë qeta, me qet’ staf kena startu. E kjo veç ka qenë e vendosne domethonë, vizitorë e di që ka

pasë shumë edhe diqysh t'u ka imponu në atë pjesë ku osht' tash Galeria se edhe ata që ishin bojshin tregti, domethonë, Qendra Tregtare u konë. Tana mbas ksajna, mbas "Boro Ramizit" ka qenë tregu atëhere. Domethonë, edhe ata që shkojshin në treg, me kese vishin edhe hishin direkt në galeri. Domethonë, vizitorë ka pas tepër shumë, të krejt profileve, jo vetëm artista, të mos flasim për ta. Domethonë, ka qenë një kënaqësi, një përvojë, një diçka krejt ndryshe për mu edhe shumë kandëshëm me artista mu njoftu, une e re isha në atë moshë, vision ma të vjetër unë as nuk i njifsha, domethonë u dufke mu prezentu kush osht' derisa një periudhë bajagi të gjatë i njofta veç të gjithë.

**Erëmirë Krasniqi:** Po ti ke qenë në kontakt bukvalisht me krejt artistat ma eminentë të kohës.

**Lirije Buliqi:** Po.

**Erëmirë Krasniqi:** Secili ka ekspozu në Galeri. Qysh ka qenë qekjo me qenë pjesë e një momenti qaq kyç për zhvillimin e arteve vizuele?

**Lirije Buliqi:** Po tash çdo artist qe vike ajo ose ka qenë... është parapa me... se zakonisht u bo, një vit përpara u bo...

**Erëmirë Krasniqi:** Programi.

**Lirije Buliqi:** Programi. Vishin u interesojshin ose për termin ose për dokumentacion, material bishin për katalog. Domethonë, u shtypke atëherë me makinë mekanike, domethonë ajo pak si punë fizike u llogaritke se u dufke nëse i bojshe me, po me shtyp, nëse ki dashtë me bo ma shumë kopje, për shembull nëse u bojshin dy kopje shumë ma lehtë, e nëse u bojshin tri kopje u dufke me fuqi edhe ma të madhe me shtyp shkronjën, nëse gabojsh u dufke krejt fletën me shky, me përsëritë se s'kishe qysh me korigju (qesh).

Domethonë, ka qenë punë e lodhshme, që të merke kohë shumë. Domethonë, u dufke me pru biografinë, veprat m'u fotografu krejt osht' ajo pregaditja e katalogjeve që bohet. Në shtypshkronjë atëherë ma shumë ka qenë i angazhum drejtori, vet i bojke, e çojke dokumentacionin, e bojke thymjen grafike të vep... të katalogut, e mbikqyrke shtypin, domethonë qashtu kem startu, po kem punu shumë. Edhe punët e para, punën e parë, se s'disha qysh funksionon domethonë shumë shpejt e përvetësova, e mbledhshim materialin, e pregaditshim, atëhere u merrke drejtori me...

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë procedura tjera keni pasë të brendshme?

**Lirije Buliqi:** Urno?

**Erëmirë Krasniqi:** A keni pasë takime?

**Lirije Buliqi:** Takime. Ka qenë Pleqësia, atëhere ka qenë Pleqësia e Galerisë. Nji here në vit Pleqësia u mbledhke dhe e caktojke programin. Kanë qenë anëtarët e jashtëm edhe drejtori çdo herë ka qenë prezent aty dhe bashkëpunëtori Engjëll Berisha. U caktojshin terminet, në të vërtetë terminet jo bash, vetëm programi kush ka me ekspozu atë vit. Varësisht tani kush ishte ma i përgaditun organizohej për të ekspozita. U bojke parallogaria financiare për tanë vitin që e financojke Ministria e Kulturës, atëhere BVI-ja për Kulturë. Mirëpo, atëherë krejt mjetet që i kërkojshim u derdhshin në llogarinë e Galerisë. Nëse për një ekspozitë nuk janë kërku mjete të mjaftushme e kemi plotësu prej mjeteve tjera, domethonë në fund është dashtë m'u harxhu ajo pjesë e mjeteve.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh ka fillu m'u rritë stafi i Galerisë?

**Lirije Buliqi:** Stafi mas dy viteve tek ka fillu me u rritë edhe është pranë kustos për vepra, bashkëpunëtorë profesional, qeto, qesi tituj ka pasë atëhere. Ka pasë edhe bibliotekë, po mendoj libra, janë ble shumë libra atëhere u konë fondi i posaçëm për...

**Erëmirë Krasniqi:** Ishte pjesë e njejtës hapsinë apo qysh?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë veç ni zyre e madhe aty, e aty ka qenë edhe biblioteka faktikisht, amo në bibliotekën profesionale veç na kena pasë qasje në ato libra. Atëhere fillun edhe me ble vepra, domethonë me fondin që e ndajshin, kem ble vepra, sidomos kena ble grafika prej ktyne jashtë, të republikave tjera, është... edhe kanë dhuru shumë vepra.

**Erëmirë Krasniqi:** Okej, qitu po na lem pak. Në fillim kur keni ardhë Galeria veç e ka pasë ni fond ekzistues, që është trashëgu prej Qendrës Propagandistike Kulturore, qysh e ka pasë emrin...

**Lirije Buliqi:** Kulturore, po. Edhe prej Ministrisë të Kulturës që kanë pasë, domethonë qajo pjesë...

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë kolekcioni ka qenë, a mundesh me na fol pak për ato, qysh o pasunu?

**Lirije Buliqi:** E ato kur kom shku, veç i kena gjet ato veç jonë kry para disa mujve kur fillova une në punë, ato veç kanë qenë, jonë dorëzu normal me proces-verbal, prejardhje e secilës vepër është e cekme.

**Erëmirë Krasniqi:** E evidentume.

**Lirije Buliqi:** E evidentume. Tana faktikisht u praktikojke kur kishte... kur ishin ekspozitat personale u blejke, për shembull dy vepra, u blejke edhe dikush nëse dojke, normal e dhurojke njo për fond. Edhe mjaft ka qenë e pasun, në qat' mënyrë osht plotësu, po.

**Erëmirë Krasniqi:** E kush u bashkangjitë mandej ose qysh filloj m'u rritë?

**Lirije Buliqi:** Me qat' staf kemi qenë shumë vite.

**Erëmirë Krasniqi:** A prej '82-shës e tutje?

**Lirije Buliqi:** Jo, prej... stafi u rrit, domethonë kur ka ardhë me gjashtë vetë kena nis u bonëm tetë vetë. Domethonë me qata tetë vetë na një periudhë shumë të gjatë kena punu, deri...

**Erëmirë Krasniqi:** Kush ka qenë, Blerim Luzha?

**Lirije Buliqi:** Blerimi edhe Rexhep Goçi.

**Erëmirë Krasniqi:** Edhe Rexhep Goçi, edhe këta si kustos?

**Lirije Buliqi:** Si kustos. Po njëni përgjegjës për fond të Galerisë, tjetri është për bashkëpunim edhe Engjulli ashtu ka qenë. Po thom me qet' staf kena punu një periudhë shumë të gjatë edhe kemi pasë ekspozita shumë të mëdhaja ndërkombëtare. Në atë periudhë e kemi pasë edhe Pikasson edhe Calder<sup>1</sup>, prej fondit të Muzeut të Arteve të Shkupit, atëhere është dashtë me lyp përforcim prej policisë që me me... objekti. Edhe pse ai ka qenë i sigurum, në "Boro Ramiz" që ka qenë sigurimi i krejt qendrës edhe shtesë kena lyp policë prej, sa ka zgjat ekspozita, me...

**Erëmirë Krasniqi:** Me e siguru ekspozitën.

**Lirije Buliqi:** Me siguru, po. Kur u bojke hapja, ditën kur u hapke ekspozita domethonë ish vepra aty, ka qenë distanca për mos me u afëru shumë afër, me ni shirit ka qenë e ndame. E kur u kryjke në mramje ekspozita Pikassos, veprën u dufke me shti në zyre te une në kacë (qesh) të metalit.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë edhe qesi situata tjera? Kur u dashtë me... në hapsirën...

**Lirije Buliqi:** Po situata... po, jo. Po, kem pasë... s'ka pasë nevojë për polici po mendoj për atë hapësirë se ka pasë, u konë sigurimi, thashë edhe ma parë. Edhe kem pasë ekspozita shumë të mëdhaja edhe me... kur filloi edhe bashkëpunimi me Shqipërinë. Domethonë, ka qenë Odhise Paskali, Abdurrahim Buza, domethonë në atë kohë ka qenë tepër, tepër i rritun numri i vizitorëve.

**Erëmirë Krasniqi:** A po më tregon ma shumë për qet' bashkëpunim, qysh ka fillu këto dy vende me komuniku në nivel kulturor?

---

<sup>1</sup> Alexander Calder (22 korrik 1898 - 11 nëntor 1976) ishte një skulptor amerikan, vepra e të cilit kryesisht i kushtohet artit kinetik.

**Lirije Buliqi:** Atëhere ka qenë edhe Enti për Bashkëpunim Ndërkombëtar, domethonë ka qenë në mes Ministrisë së Kulturës edhe Galerisë edhe Gale... po mendoj bashkëpunim me ftesë të Galerisë për ekspozim, Abdurrahim Buza edhe ky, Odhise Paskali. Domethonë, atëhere ka qenë ajo fluksi ma i madh i vizitorëve. E une kur s'kom qenë, domethonë '79-tën kur është hapë Galeria ka qenë edhe kjo, Njiqind vjetori i Lidhjes së Prizrenit, atëhere ka qenë, qysh kom dëgju, ka qenë numri shumë i madh i vizitorëve, që u dufke me grupe-grupe me hy.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundesh me përshkru pse ka qenë aq me rëndësi, p'e kuptoj që ky elementi identitar...

**Lirije Buliqi:** Po kufijtë kanë qenë atëhere, për herë të parë ka fillu në atë kohë bashkëpunimi. Domethonë, u hapën kufijtë për bashkëpunim kulturor, atëhere vazhdoi...

**Erëmirë Krasniqi:** Edhe pse ka qenë me rëndësi me pa çka po ndodhë me artin vizuel në Shipni...

**Lirije Buliqi:** Ato ma shumë kanë qenë individuale, se që kanë shku... për shembull për veti e di që për herë të parë në Shipni m'u ka dhonë rasti me shku në vitin 2006 (qesh). E kështu që...

**Erëmirë Krasniqi:** Po artistat kanë shku, nuk osht' që nuk kanë shku...

**Lirije Buliqi:** Po, përmes Galerisë jo. Nëse kanë shku, kanë shku në mënyrë individuale. Nuk jonë... pamvarësisht përmes Galerisë jo, niherë jo.

**Erëmirë Krasniqi:** Po përmes BVI-së.

**Lirije Buliqi:** BVI-së së Kulturës, po. Atëhere ka qenë ajo që e ka bo financimin e aktiviteteve.

**Erëmirë Krasniqi:** E a mundesh me na tregu pra ma shumë për programin e Galerisë, gjatë këtij dhetë vjetshit të parë? Se veç e ki parasysh, po më intereson edhe se ju keni qenë pjesë e Jugosllavisë, keni pasë komunikim me shumë galeri tjera nëpër krahina edhe nëpër republika tjera. Qysh ka qenë ky shkëmbim?

**Lirije Buliqi:** Bashkëpunimi ka qenë këmbimi i ekspozitave, domethonë na e kemi marrë një ekspozitë prej Republikës së Kroacisë, domethonë në vitin e ardhshëm, në vitin vijus e kem dërgu na një ekspozitë atje. Bashkëpunimi ka qenë në nivel shumë të lartë, domethonë kemi pas ekspozita shumë të mira me Kroaci, me Ljubljanë, me Malin e Zi edhe ka qenë bashkëpunimi ndërkombëtarë. Domethonë, nëse ka shku në Kroaci një ekspozitë ndërkombëtare që ka qenë me vlerë të naltë, ka shëtitë ajo ekspozitë, domethonë ka ardhë edhe në Prishtinë. E nëse i kemi pasë na ndërkombëtare prej Shipnisë për shembull, nuk osht' ndal vetëm në Prishtinë me Tiranën po kanë shku nëpër komuna

tjera. Ka qenë në Podujevë, Gjakovë, në Pejë, domethonë osht' ekspozu e njejta ekspozitë. E këto ndërkombëtare domethonë kanë shku në këmbim.

**Erëmirë Krasniqi:** Domethonë, Galeria e ka pas edhe këtë qasje me afriu artin edhe komunave tjera. I keni çu edhe nëpër galeria tjera ma të vogla, po njëkohësisht keni qenë pjesë e njëfarë rrjeti ma të madh që i ka qarkullu ekspozitat, çka ka ndodhë në Ljublanë, ka ndodhë edhe në Prishtinë...

**Lirije Buliqi:** Po ka ndodh edhe ajo, ose i kem çu na, ka shku në Beograd, ka shku edhe në Zagreb ose e kundërta. Nëse ka ardhë prej atjehit na e kem çu, po jo shumë se s'ka pasë galeri këtu, domethonë të vogla kanë qenë. Po në Gjakovë sidomos kanë shku...

**Erëmirë Krasniqi:** Shtëpia të kulturës?

**Lirije Buliqi:** ...në Gjakovë edhe në Mitrovicë u kanë njëfarë... po ka qenë.

**Erëmirë Krasniqi:** E çfarë arti u promovojke?

**Lirije Buliqi:** Po ma shumë atëherë ka pasë piktura, piktura edhe skulptura domethonë pamore. Jo me video, me kësi, s'ka pasë atëhere. U mbajshin ligjerata, ka pas kritik të artit që kohë mas kohe vishin, u interesojshin për artista, i çojshim nëpër atelje edhe ashtu edhe ka funksionu. Për shembull, nëse është formu ni komision prej disa artistave edhe kanë shku në vizitë në atelje te një artist i caktum, kanë shiqu punimet, osht' vlerësu që bon me marrë pjesë apo jo, me sa punime, domethonë gjithmonë ka qenë një komision.

**Erëmirë Krasniqi:** A ke shku ti me ta nëpër atelje?

**Lirije Buliqi:** Une rrallë, ma rrallë kom shku se pak a shumë staf i vogël osht' dashtë me qenë dikush në Galeri. Une kom shku, për shembull kom pasë mundësi me shku në Shkup, në Ljublanë edhe në Kroaci.

**Erëmirë Krasniqi:** Keni shku me kriju raporte, me marrë punë?

**Lirije Buliqi:** Faktikisht, zyrtarisht ka qenë, takimet i kemi mbajtë, kryesisht drejtori me artista apo në naj Galeri që kemi shku. Domethonë, qeto vende i kom, i kom, kom marrë pjesë. Në Ljublanë poashtu kom pasë rast poashtu me shku, te Jozhe quhet, në atele tina edhe ka qenë një përvojë shumë e mirë, e madhe për mu, me pa ni atelje të një artisti të madh që ishin, që kish tepër punime. Tepër të mira, që do të thotë vlerësohen në krejt botën.

## Pjesa e Dytë

**Erëmirë Krasniqi:** Isha kthy prapë te Galeria, por, po mendoj çka ka ndodhë paralelisht edhe ju mandej keni vendosë me studiu edhe skulpturë?

**Lirije Buliqi:** E unë, po mendoj, tash gjatë përvojës që veç u bonën qe dy vite, une studimet i lash. Domethonë, juridikun mo nuk pata kohë me mësu. E i ndjeri Engjëll Berisha, ai më ka vërejt që kom talent, se une pak u merrsha, jo vizatojsha diçka kur e kisha kohën e lirë, ose kqyrsha libra, ose i shfletojsha katalogjet. E m'i ka pa do vizatime që une i kom bo për veti ashtu me kalu kohën, kur isha ma e lirë, edhe ai më shtyni, më shtyjti (qesh) për me, me regjistru akademinë edhe pse mu në atë moment më vike keq, thojsha, "Krejt profesorat po vijnë këtu mendojnë që duhet..." a din si me kry me të njofshëm, atëhere ka qenë (qesh) tjetër edukatë.

Nejse, vendosa ma në fund, konkurova, provimi pranues ka qenë pesë ditë, kom punu shumë, jom vlerësu edhe jom pranu. Skulpturën e kom zgjedh sepse mu më pëlqejnë ma shumë materialet ma të vrazhda, domethonë balta e këto. Ndoshta më ka mbetë edhe prej fëminisë që s'kemi pasë lodra edhe kemi lujt me baltë. Mirëpo, u pranova, problemi ishte a muj me shku në ligjerata bashkë me studentët e rregullt. Por e kisha fatin që hasa në mirëkuptim dhe drejtori ma lejoi, normal në prezencën edhe të anëtarëve tjerë të stafit që shprehën...

**Erëmirë Krasniqi:** U pajtun.

**Lirije Buliqi:** U pajtun që nëse ka nevojë më zëvendësojnë për një orë, një orë e gjys sa jom në ligjerata. Kom diplomu me kohë, ka qenë përvojë e mirë, jom knaq. Kemi punu shumë, por kushtet s'i kemi pasë shumë të mira. Në Akademi na kanë mungu materialet që me punu skulptura. Nëse ka pasë baltë, atëherë veglat është dashtë m'i ble, gipsin e këto është dashtë m'i ble. Si studentë kemi pasë shumë shpenzime, sepse Akademia s'ka pasë mundësi t'i mbulojë ato. Pra, po foli për kohën kur kom studju une.

Dimrit, për shembull, atelieja ka qenë tepër e ftohtë, balta ka qenë e ngrime s'kishe mundësi me punu me të. Tani punojshim diçka me letra, improvizojshim diçka me skulpturë, veç ashtu disi e kemi kry. Une kom qenë në klasën e të ndjerit Agim Çavdërbasha, mirëpo vitin e fundit ai s'ka qenë mirë me shëndet, në spital ka qenë në Ljubljana. Notën e kam marrë te Zoran Karalejić<sup>2</sup>, i cili e ka zavendësu atë në të '90-tat e hershme.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë tjerë skulptorë, a këta kanë qenë kyç për departamentin e skulpturës?

---

<sup>2</sup> Zoran Karalejić u diplomua në Fakultetin e Arteve në Prishtinë në vitin 1978. Në vitin 1994, ai e mori titullin profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve të Bukura në Prishtinë. Në periudhën 1988-1991, ai ishte prodekan. Ndërsa, gjatë viteve 1991-2001 ishte Dekan i Fakultetit të Arteve të Bukura në Prishtinë.



**Lirije Buliqi:** Ka qenë Agimi edhe Zoran Karalejić.

**Erëmirë Krasniqi:** S'ka pas tjerë?

**Lirije Buliqi:** Ka pas edhe ky... këta dy janë konë në atë kohë.

**Erëmirë Krasniqi:** Ç'a keni mësu prej tyne, kanë qenë edhe dy figurat kyçe, po mendoj Karalejić ka qenë student i Çavdërbashës, po Çavdërbasha ka qenë kryesori.

**Lirije Buliqi:** Ka qenë, por po thom në atë periudhë kur unë kom studiu, ai ka pasë probleme me shëndet. Kështu që, punojshim, ai na jepke detyrën, mirëpo s'ka qenë krejt kohën me ne që me na përcjellë, i ka përcjellë punimet, por Karalejić e mori klasën tonë përsipër. Ai mundohej me përciellë punën, por s'kishte diçka që... nëse kemi pasë nevojë me pyt diçka, por kryesisht kemi punu vet.

**Erëmirë Krasniqi:** Mu çka po më kujtohet prej këtyne librave që u promovojshin në Prishtinë, ish që ka ekzistuar gjithmonë njëfarë panairi në oborr të Rektoratit, ku jonë prezantuar skulpturat e ndryshme, a ka qenë pjesë e kulturës?

**Lirije Buliqi:** Une jo, jo nuk besoj që ka qenë. Veç nëse kanë punu studentat, nëse kanë punu. Ose nëse ka qenë program i Akademisë, se përndryshe nuk e di, nuk jam e sigurt. Se une skom qenë...

**Erëmirë Krasniqi:** Deshta me ditë, a është promovu edhe në sferën publike skulptura, a ka qenë...

**Lirije Buliqi:** Studentat për shembull kur e kanë kry vitin osht' mbajt një ekspozitë, ajo osht' si... mas përfundimit, mas marrjes notës, qaty e di që kena pasë ekspozita. Përndryshe, tjetër diçka nuk di. Se kur ka qenë kjo Akademia, ajo skulptura ka qenë, do baraka i kena pas tash ku osht' kjo kisha e pakryme, qaty i kena mbajtë domethonë. Une për veti s'kom ndejt ma shumë, se ora kur është kry, kom vazhdu jom kthy në punë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë në Galeri ekspozita me skulpturë, veç po më intereson statusin e skulpturës në atë kohë, a është promovu?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë ekspozita e Agim Çavdërbashës, ka pasë ekspozitë Svetomir Arsić<sup>3</sup>, domethonë është promovu. Ka qenë një prej Nishit, një artiste, por që tash nuk po më kujtohet emri, do skulptura shumë interesante i ka pasë. Ke qenë ky prej Shkupit, tani prej Shqipnisë, ekspozitë e skulpturës prej Shqipnisë që është realizu përmes bashkëpunimit që kanë pasë të dyja galeritë. Domethonë, ka pasë ekspozita në të cilat është prezantuar skulptura mjaft.

---

<sup>3</sup> Svetomir Arsić - Basara është skulptor dhe historian serb, i lindur më 15 maj 1928 në fshatin Sevac, të maleve të Sharrit.

**Erëmirë Krasniqi:** E '81-ta, demonstrata e studentëve a e afektoj në najfarë mënyre Galerinë edhe jetën, bashkëjetesën.

**Lirije Buliqi:** Jo, në punë nuk ka... nuk është reflektu shumë, se diqysh artistat kanë qenë më pak të kyçun, ashtu po mendoj. E na kena pasë probleme për shembull me këto hapsinën, ku ka qenë Galeria, kem pasë probleme atëherë me... na ndërprejshin rrymën. Ndoshta nuk ka qenë ajo në kuadër të protestave po ka qenë që për shkak të qirasë, kostoja shumë e madhe ka qenë, s'ka mujt me përballu ministria. Domethonë, qaty kem dështu një periudhë, kem dështu, kem pauzu.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Lirije Buliqi:** Kështu që, ka qenë e hapun këtu nëse ka qenë me, qysh me thonë {përshkruan me duar} dimensione ma të vogla, për shembull kanë qenë, që kanë shku edhe nëpër Kosovë, Prishtinë, Pejë, Prizren, Podujevë e di që kanë shku, Mitrovicë, këto kanë shku, jo secila.

**Erëmirë Krasniqi:** I keni eduku njerzët për arte pamore.

**Lirije Buliqi:** Ato kryesisht kanë shku, këto të Shipnisë që kanë qenë, se për tjera s'kanë mujt, domethonë që jonë konë ma lehtë.

**Erëmirë Krasniqi:** E në qytet a u koncentru ma shumë komuniteti, a kishin adresë a?

**Lirije Buliqi:** Tash veç kishin adresë. Edhe pse atëherë jonë mundu edhe këta të rihtë, studentat e ri, këta që kanë kry edhe si studenta diploma e '80-shit osht', osht' bo një ekspozitë. Tana ka shku ekspozita në, krejt artistat e ri kanë shku edhe në Japoni, kanë shku në Paris, domethonë...

**Erëmirë Krasniqi:** Domethonë, Galeria ka shëtitë edhe në pikat...

**Lirije Buliqi:** Po.

**Erëmirë Krasniqi:** Njëfarë pike e cila i ka shpërnda artistat, i ka ekspozu në vende tjera.

**Lirije Buliqi:** Po, po. Sidomos në Japoni u konë shumë, ka pasë edhe në Paris kanë shku.

**Erëmirë Krasniqi:** A kanë shku vetëm përmes Asociacionit të Artistave edhe përmes Shoqatës edhe Galerisë?

**Lirije Buliqi:** Edhe shoqata atëherë u konë, u konë e kyçne në këto, qysh me thonë, aktivitetet e shoqatave kanë ekspozu në Galeri edhe Shoqata e Artistave Figurativë edhe Aplikativë, domethonë e kanë pasë ka ni termin.

**Erëmirë Krasniqi:** Edhe fakulteti për ekspozitën finale, a po?

**Lirije Buliqi:** Fakultetit, jo {mohon me kokë}, në Galeri, jo.

**Erëmirë Krasniqi:** Akademia e Arteve s'e ka pasë ni termin?

**Lirije Buliqi:** Galeria, ja-a, akademia ja-a, për studenta ja-a, veç këto që... Nihere e di që '80-shin është bo një ekspozitë, diploma është qujt, qajo gjeneratë e artistave në '80-shin kanë pasë ekspozitë edhe mo nuk osht' praktiku. Masi e kanë pas a din, se ajo... faktikisht i mbajshin nëpër, në akademi i mbajshin qato, notat i merrshin edhe u ekspozojshin punimet e studentave.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Lirije Buliqi:** Atëhere gati çdo ekspozitë që është bo është këmbi, domethonë ti e ki pru, çdo vend që e ka pru na vitin e ardhshëm kena çu diçka. Bashkëpunim, këmbim i rregullt ka qenë.

**Erëmirë Krasniqi:** Reciprocitet.

**Lirije Buliqi:** Reciprocitet, po. {vendos syzet dhe shikon poshtë} Qe qito kanë qenë, {shikon poshtë shënimet} qe koka konë në Irlandë, Gllasgou, Holandë, Britani e Madhe, ... Sarajevë, krejt çka ka shku grafika, '85-tën.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë ma e zhvillume grafika a çka?

**Lirije Buliqi:** Ma, ma e zhvillume, se këto... grafika ka qenë ma e zhvillume edhe ma shumë osht' ekspozu. Tash a u konë për shkak transportit a kësi veprave, nuk e di veç, jonë konë ma shumë... kqyre gjithmonë ka ekzistiu shoqnia ma, gjithmonë me drejtorin, se ky, ky Shyqriu o konë me seriografi qesi është marrë, me pllakata, me ato. Si duket grupin e ka pasë Fatmir Krypa, Hysni Krasniqi, tani jonë konë do, ky, {vendos syzet, shikon shënimet} Fatmir Krypa, këta jonë konë ma të rregullt, vishin, Ymer Shaqiri.

**Erëmirë Krasniqi:** Po, kanë qenë edhe në Bienale në Slloveni.

**Lirije Buliqi:** Në Bienlae, Bienale kanë qenë, tash unë.... Domethonë, në Irlandë u konë edhe në Japoni u konë {shikon shënimet}, qe në Budvë ka shku, Nju Delhi ka shku. Qe për shembull Xhevdet Xhafa u konë, Nju Delhi, [lexon shënimet] Xhevdet Xhafa, Destil Marković, Dimitar Kondovski. Krejt jonë shku këta në Nju Delhi.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Lirije Buliqi:** Atëhere ka qenë, për punësim u konë ni dallim, se s'ë kom cek, domethonë u konë tre me ni. Tre shiptarë (qesh), tre sërbe e një shiptar. E këtu bashkëpunimi ka qenë gjithmonë i përbashkët, janë ftu artistat, s'kanë konkuru. Atëherë u konë, ata që jonë konë ma aktivë jonë ftu për në ekspozitë grupore kanë shku nëpër vende tjera.

**Erëmirë Krasniqi:** Edhe gjithmonë jeni siguru me pasë përfaqësim të krejt komuniteteve.

**Lirije Buliqi:** Gjithqysh, po, po. Ka qenë si obligative me thonë. Veç ka funksionu, ka pasë artistë të mirë, tonët edhe të atynve.

**Erëmirë Krasniqi:** Krejt komunitetit.

**Lirije Buliqi:** Krejt komunitetit, po {pohon me kokë}.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka diçka që kishe dashtë me shtu para se me mrri te '89-tat? Për punën e Galerisë edhe për programin e saj publik, ligjeratat?

**Lirije Buliqi:** Ka pasë ligjerata, vishin edhe kësi, qysh me thonë, ky Vlada Bužančić për shembull ka pasë ardhë, kritik i artit, ka mbajtur ligjeratë këtu. Kanë qenë do të Beogradit kanë mbajtur, domethonë vishin mediat, vishin kush ka qenë i interesum, artistat, për me ndëgju ligjeratën, edhe... s'po di.

**Erëmirë Krasniqi:** A krijojshit opinion për çka po bon Galeria, domethonë mediat paskan shkru për Galerinë...

**Lirije Buliqi:** Në media gjithmonë është shkru, një periudhë ka shkru... po menj krejt mediat kanë shkru, edhe kjo "Jedinstvo" u konë ni kohë të gjatë që çdo herë e ka përcjell punën e Galerisë me, me, me kritikë pozitive. E ma vonë veç fillunë, krejt qato, i njëjti gazetar ka qenë që filloi të kundërtën me bo. Atëherë, veç fillun qato trazinat qato, fillunë nifare dallimi me u bo. Çka do që u punojke u kritikojke prej tyne.

**Erëmirë Krasniqi:** Kjo osht' ma shumë ka '88-'89.

**Lirije Buliqi:** Atëherë, po. Ajo dukshëm u vërejtë...

**Erëmirë Krasniqi:** E çka ishte arsya, pse dojshin me damtu punën, masi ishte e përbashkët, e krejtve?

**Lirije Buliqi:** Po atëherë... po qikjo ish, ish... edhe kur ekspozojshim, kur ishin ekspozitat e përbashkëta dhe për shembull, nëse ni sërbe ka marrë pjesë në qeto ekspozita është kritiku, gjithmonë është shajt. Edhe përgaditja e kësajna, e programit të Galerisë edhe programi në pëgjithësi, ekspozitat

fillun krejt negative. Bile, kena pasë njiherë nji kontroll si me thonë, ka qenë policia në bashkëpunim me Entin për Marrëdhaje Ndërkombëtare, që ka qenë atëherë në funksion, kanë ardhë t'u mendu që simbas shkrimeve çka është shkru mos po gjejnë diçka, domethonë krejt ka qenë në rregull edhe me lajmërimet e ekspozitave, me programet që janë parapa, edhe çdo gja që ka qenë në rregull që është bo. Atëhere fillojshin me kqyr këto, a osht' dygjuhësia, a osht' tu shku paralel me shqipen. Domethonë, gjithqysh u konë obligative edhe anglisht normal, çdo katalog e ka pasë anglisht, serbisht, shqip.

**Erëmirë Krasniqi:** Ia filloi njifarë kontrolli ma i shtum?

**Lirije Buliqi:** Atëherë ma i shtum, ma shumë prej gazetarëve se tana veç nuk ka pasë nevoj, njeherë ka ndodhë nashta kanë pasë informata të gabushme, amo jo mo kurrë.

**Erëmirë Krasniqi:** Mandej qysh, deri kur ka qenë Shyqri Nimani aty?

**Lirije Buliqi:** Ka qenë...

**Erëmirë Krasniqi:** Ka qenë dhetë vjet, apo?

**Lirije Buliqi:** '90-tën, dhetë vjet ka qenë, dej '90-tën. '91-shin tana u ndrru drejtori. Shyqriu e kryjti mandatin, dy mandate. Erdhi drejtori i ri, tana hasëm na në pengesa tjera, se tash se kjo, qysh me thonë, financimi, financimin e Galerisë tash e bojke Ministria [e Kulturës] e Sërbisë.

**Erëmirë Krasniqi:** Po, e kemi hup autonominë si territor, mandej...

**Lirije Buliqi:** Po, u hup. Atëherë kena pasë probleme financiare shumë, domethonë as aktivitete s'kena pasë shumë, rrymën na ndalshin, e mbyllën Galerinë, faktikisht nuk mujshim as me hy brenda deri sa u bo ni zgjidhje. Atëhere, ke ky Muzeu i Revolucionit qysh ka qenë na tash që osht' Galeria, ka qenë Muzeu i Revolucionit. Ata e transformun me vendim të Ministrisë të Kulturës të Sërbisë, u transformu, po fati punëtorët kalun në Muzeun e Kosovës. Domethonë, s'ka mbetë pa punë kërkush, amo galeria i mbet, i mbet, i mbet ndërtesa Galerisë. Se na kem shku nihere na lirun ata me vetdëshirë, drejtori i Muzeut të Ko... i Muzeut të Revolucionit, na lëshoi dy zyre për me funksionu, mënyrë funksionale s'ka qenë aspak veç që kem ndejt s'ka pasë aktivitete.

**Erëmirë Krasniqi:** Sa vjet... ?

**Lirije Buliqi:** Ajo ka ndejt nja tre vjet, ajo ka qenë '92-shi, '92-shi, deri '93 u ndrru drejtori tana, nihere deri '93 kemi qenë me dy zyre, atëhere kur u transformu Muzeu, i mbet Galerisë. Aty na fillum me do aktivitete, se u bonë masat e dhunshme erdh drejtori sërb, atëherë u bonë ka tri-katër ekspozita. Fillimi ke që u mbajt "Salloni pranveror" i Kosovës, morën pjesë shumica sërbë, as katër-pesë vetë shiptarë nuk u thirrën ftesës. Domethonë, tani fillum me bojkotu na shiptartë edhe pse disa katalogje

janë shtypë, janë disa pjesëmarrës, po jo ashtu me numra ma të madh se zakonisht që kanë qenë të interesum. Tana do ikona të manastirit...

**Erëmirë Krasniqi:** A filloj me ndrru edhe kolekcioni?

**Lirije Buliqi:** Jo, kolekcioni nuk osht' prek.

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, po mendoj a fillun këto problemet politike me u reflektu në çfarë lloj pune u bo...

**Lirije Buliqi:** E tash ajo u lidh edhe me politike, edhe u lidh me hapësinë që s'kishim. Tash hapësina ishte e Muzeut, aty ata kishin aktivitete të tyne. Na... domethonë, tri ekspozita u realizun.

**Erëmirë Krasniqi:** Të njëjtën hapësirë të Muzeut i relaizojshit a?

**Lirije Buliqi:** Po, ja-a për neve u mbyll, u tërhekën, veprat u tërhekën, kështu që në qato kushte, për disa vjet jonë konë ka tri-katër ekspozita edhe kryesisht sërbe ose maqedonë. Mali i Zi ka pasë, me ikona qato. Edhe tash njeni ka pasë edhe ky nji artist skulptor...

**Erëmirë Krasniqi:** A u ndrru stafi?

**Lirije Buliqi:** Stafi te na jo, stafi u shtu. Erdhe kustosi tash, erdh Bilana Vraniqi, tjetër s'ka pasë. Tana erdhën do kësi, *izbeglica* [srb. refugjatë] (qesh).

**Erëmirë Krasniqi:** Refugjatë.

**Lirije Buliqi:** Refugjatët erdhën prej, prej luftnave, prej Bosnjes, aty erdhën tre, tre punëtorë veç u pranun.

**Erëmirë Krasniqi:** Te ju në Galeri?

**Lirije Buliqi:** Në galeri, u bonën pjesë. Nejse s'kanë qenë, kanë qenë pastrus e qeso, veç kustose ka qenë kjo, tjetri u konë punëtor teknik edhe deri sa u mbyll, filloi lufta.

**Erëmirë Krasniqi:** A pat, a ka... veç para se me u ngut aty, shpejt. Çfarë lloj artistë aty ekspozojshin a përnime shumë u vërejtë... ekspozitat u drejtun ka ikonat, a qysh?

**Lirije Buliqi:** Veç ikona jo, ka pasë edhe do... duhet me kqyr, se emrat...

**Erëmirë Krasniqi:** Jo, veç mendimin tond, a ka pasë, a s'ka pasë?

**Lirije Buliqi:** Jo, ka pasë edhe piktura, ka pasë grafika, ka pasë skulpturë, bile sa deshta me thonë që ky artisti...

**Erëmirë Krasniqi:** Arsić.

**Lirije Buliqi:** Arsić, i ka ekspozu punimet e veta, pat në Galeri ekspozitë, po tani do punime i lypi në huazim, në revers i lypi 20 skulptura për me i çu në Beograd edhe ato nuk u kthyn kurrë. Domethonë, ato veç i mungojnë fondit.

**Erëmirë Krasniqi:** I nxuni lufta, a qysh?

Po, lufta i nxuni edhe ato ishin atje. Por, tani une ma vonë i kërkova, nuk lejoi, tha, “Mu m’u ka kallë shpia [nga lufta]”. Me atë arsyetim ai nuk i ktheu punimet. Edhe pse ceket nga ana e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë që veprat e Arsić janë nga fondi i Galerisë Kombëtare.

**Erëmirë Krasniqi:** E gjatë luftës, a shkojshit në punë, gjatë bombardimeve?

**Lirije Buliqi:** Gjatë luftës, bombardimeve kemi shku pak, ka disa orë. Mbetëm tre-katër veta që nuk dishim çka me bo, se shumica e shiptarëve e lëshun punën. Dikush me detyrim e lëshoi, por na në Galeri nuk patëm presion kurgjo, as nuk na kanë pru me nënshkru diçka që s’e kishim pranë. Por, tani u konsultum me ish Ministrin e Kulturës, z. Bicaaj, ai na tha që, “Nëse serbët s’kanë pru kurgjo, s’keni presion, mos e lëshoni punën”, se krejt e lëshun, “mos e lëshoni punën me asnji kusht!” Kështu që, na nuk e lëshum punën, vazhdum, por dy javë e di që na kanë liru prej punës.

**Erëmirë Krasniqi:** Me çfarë preteksti?

**Lirije Buliqi:** S’ka pasë, me arsyetim që, “S’keni nevojë me ardhë këto dy javë”. Lidhje s’kemi pasë pse.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë periudhe, në fillim?

**Lirije Buliqi:** Po, ka qenë fillimi, bash fillimi. Atëhere kur fillun krejt këta me u përzonë prej shpive dhe të deportohen. Domethonë, dy javë, mandej u lajmrum prapë, po tani ke afati i shkurtë ata veç u detyrun me shku. Më vonë erdhi edhe drejtori, në të vërtetë drejtori s’ka ardhë, por ke një që erdhi... kur e lëshun punën serbët, domethonë serbët u detyrun me lëshu punën, tani na mbetëm. E tash prej stafit kërkush nuk mbeti, Blerimi, Rexhepi, këta krejt ishin jashtë. Une mbeta vetëm në Galeri një muj. Domethonë, në krejt Galerinë veç une kom qenë.

**Erëmirë Krasniqi:** E drejtori i fundit ka qenë Tanasković?

**Lirije Buliqi:** Tanasković ka qenë, po. Ai ka qenë korrekt me ne. E di që ai ka pasë probleme me kolegë të vet për shkak që ai na mbështeti, faktikisht nuk na përjashtoi prej punës. Edhe e di një rast, kanë qenë mbishkrimet nëpër zyre tona, ka qenë emri i punëtorit edhe administrata në derë, domethonë ka qenë në dy gjuhë. Kështu s'ka pasë nevojë me pasë mbishkrime, mirëpo ai i ka bo edhe serbisht edhe shqip. E di që jonë shajt ata dy mes veti, domethonë drejtori i bibliotekës serb që ka qenë me drejtorin e Galerisë. Ai prapë së prapë është tregu fer dhe korrekt me ne.

**Erëmirë Krasniqi:** A po më tregon për këtë mujin kur keni qenë vetëm në Galeri? Vetëm ju i keni pasë çelësat e Galerisë?

**Lirije Buliqi:** Po, po. Qeky muj ka qenë ma i vështiri se s'disha as...

**Erëmirë Krasniqi:** Cili muj ka qenë?

**Lirije Buliqi:** Ni muj ka qenë qashtu...

**Erëmirë Krasniqi:** Cili muj, qershor?

**Lirije Buliqi:** Qershori, qershori.

**Erëmirë Krasniqi:** Okej, qershor 1999.

**Lirije Buliqi:** '99. Ka qenë shumë e frikshme se qyteti u zbraz, nuk dishe çka me prit, kërkush në zyre, kërkush në ndërtesë. Unë isha e vetmja në Galeri, veç këto më duhet me cek që fondi nuk është prek. Domethonë, ata kanë mujt me marrë kur kanë dashtë. Ato dy javë që nuk kemi qenë në punë, kemi mendu mos po dojnë veprat me i marrë, por nuk janë prek, përveç Arsić që i ka marrë edhe s'i ka kthy. Për një muj çdo ditë t'u prit kush po vjen, a po vjen dikush me na pyt apo kanë harru krejt për Galerinë.

**Erëmirë Krasniqi:** Tregom më shumë për mujin qershor 1999, ka qenë data 12 qershor kur është çliru qyteti, një pjesë të madhe të atij muji ke qenë nën presion të madh prej serbëve?

**Lirije Buliqi:** Njihërë, po mendoj gëzimi ma i madh ka qenë kur ushtria serbe filloi me u tërhekë edhe fillun shiptarët me u kthy nëpër shpija të veta. Më kujtohet që une kom dalë mbi Kurriz edhe t'u mos i njoft njerzët, po shihen që... sepse u zbraz qyteti, kjo pjesë është shumë tmerruese, tmerrshëm u doke. Unë kom dalë në rrugë edhe ju kom thonë, "Mirësevini!" Njerz që s'i kom taku kurrë. As tash nuk i njoh, a din, veç gëzim i madh, sepse qyteti pa njerz mori një pamje si në filma horror.

**Erëmirë Krasniqi:** Zymt.

**Lirije Buliqi:** Zymt shumë edhe frikshëm se s'dishe ka jonë, ku kanë shku.



**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë paramilitarë në lagje?

**Lirije Buliqi:** Ka pasë, shumë ka pasë, po. Edhe une shkojsha pak ma vonë në pune, rrisa dy-tre orë, mirëpo në momentin që hisha në Galeri e mbyllsha derën se nuk disha tash kush vjen, veprat e fondit ishin aty, domethonë unë femër vetëm. Nji muj ditë kështu ka ndodhë. Çdo ditë kom shku në Galeri, çdo ditë visha këtu në shpi se tani rreziku këtu po më thehet banesa. A din, ka qenë nji tmerr. S'kom pasë kurrëfarë provokime në Galeri, po mendoj me ardhë dikush te dera diçka, ato ditë kërkush nuk ka ardhë.

Une kom shku në punë, Blerimi kohë mas kohe vike pak. Domethonë, nji muj ditë e di që kom qenë krejt vet në Galeri. E tani mas nji muji, ndoshta sakt me ditë s'po e llogariti, une e mbajsha Galerinë mshelë, e ndiva zilen edhe zbrita poshtë. Tash, unë Luanin [Mulliçi] e njifsha si artist, por personin që e përcillke nuk e njifsha. Ai tha, "Une jom ardhë me prezentu drejtorin e ri të Galerisë". Edhe unë normal që u gëzova. U hap dera, erdhi drejtori, u thirrë stafi që me fillu diçka me punu. Domethonë, këto kanë qenë momente të disa ditëve, por që kujtesën e kom pak të dobët.

**Erëmirë Krasniqi:** Domethonë, me Luanin fillon periudha e mas luftës?

**Lirije Buliqi:** Fillon periudha e mas luftës domethonë, po.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u rindërtu Galeria, po mendoj stafi, njerzët...

**Lirije Buliqi:** E tash stafi, tash ni pjesë nuk u konë, Blerimi erdh, erdh edhe Rexhepi mbas ni kohe, jo qysh startum na. U lajmru edhe Rrahmani, se Rrahmani ka qenë që s'ka punu rregullisht, Rrahmani u thirr, une isha. Domethonë, nihere qishtu kena startu, fillum menihere me organizim të ekspozitave, u rregullun zyret, nejtse u adaptun, gjithkush për veti edhe fillum me, me ekspozitë.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ishin ekspozitat e para?

**Lirije Buliqi:** Rihapja e ekspozitës u bo me ni ekzpozitë.

**Erëmirë Krasniqi:** Me ni ekspozitë, çfarë natyrë e ekspozitës?

**Lirije Buliqi:** Me ni ekspozitë, po. Nejtse ke edhe kjo "Golgota Kosovare" ke ni grup t'artistave që u bo. Domethonë, ke ajo kënaqësia ma e madhe që më duket sikur kur jom punësu edhe qekjo ka qenë rihapja kur u bo. Artistat të gëzushëm, s'dishim... emociione, shumë të interesum për me ekspozu. U bo hapja erdhën plot artista, erdhën ndërkombëtarë, ka pas edhe ndërkombëtarë rregullisht që vishin. Tanaj u bo rihapja e konkursit për rik konkurim na që ishim punëtorë të vjetër, qashtu simbas UNMIK-ut u bo edhe konkurum na për vendet tona.

Tani u pranum, ni staf ma profesional jo veç qishtu. Niherë kem startu se edhe mjete nuk kena pasë në fillim. Bile, pare s'kishim, rroga s'kishim, po me donacione filloi drejtori Luani, ai u gjind, bile rrogat na sigurojke më duket ai ka pasë fillu edhe me pare t'veta me punu veç mos me na lon keq, se rroga s'kishim, as material kurgjo s'kishim, pi kurçkafit. Tana me donacione fillum qishtu, filloi aktiviteti, fillun edhe konkurset e reja m'u hap, vende të punës, u fillun ekspozitat e radhës që ishin. Tana u formu ky Bordi artistik, tanaj Bordi drejtus, se ajo ka qenë niherë artistik qysh mendum, po u bo Bordi drejtus, fillun aktivitetet normale në Galeri.

**Erëmirë Krasniqi:** Mandej, kur u bonët pjesë e ministrisë, në cilin moment filloi ministria me marrë përgjegjësi për Galerinë?

**Lirije Buliqi:** Ato fillun me ato aktivitete me ato mundësi domethonë fillun po shumë, shumë ngadalë ka shku. Domethonë, fillun tana rrogat m'i marrë, u konë ni procedure e gjatë, nihere me konkurse, nihere me këto, me, qysh me thonë, bazën e rrogës, a din. Ka qenë ni periudhë shumë e koklavitne administrative, deri sa u murr ni vendim që për çdo ekspozitë me konkuru për projekt domethonë, projektin me bo për çdo ekspozitë, një nga një, që edhe tash ekziston qashtu.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Erëmirë Krasniqi:** Liri, kanë qenë do punëtori të qeramikës që i keni organizu në Galeri në kohën sa ka qenë drejtor Luan Mulliqi, a mundesh me m'kallxu ma shumë për qeto?

**Lirije Buliqi:** Po, po. Ka qenë viti 2004, në fakt viti 2003 që e kemi pasë një ekspozitë të qeramikës të mjeshtrit të madh Hanibal Salvaro<sup>4</sup>. Dhe ai na propozoi me mbajtë një punëtori, e cila u miratu nga drejtori. Për ne ka qenë... në fakultet jo se jo që janë ofru landë të tilla edhe unë s'e kom ditë si është procesi. Pra, ka qenë gëzim i madh i një grupi prej njëzetë artistëve të cilët u kyçën. Kërkesa ka qenë edhe ma e madhe, por nuk ka pasë mundësi me rritë numrin e pjesëmarrësve. Salvaro u ofru me na ndihmu, faktikisht na e kemi ble furrën që kushtojke njaft shumë, por Ministria e Kulturës e aprovoi kërkesën edhe ai kishte ngritë fonde për glazura, baltë, dhe mjete tjera që duhen për punë në qeramikë.

**Erëmirë Krasniqi:** Gjatë kësaj punëtorie ai ua mësoi disa teknika, apo?

**Lirije Buliqi:** Nejse, nihere, erdh kësine me, me vazo të formsume veç që mu aspak nuk m'tërhjekin ato edhe tha... edhe na ka pru baltë. Tash të tregova, një lloj arti që s'e kom njoft, na pruni baltën, dy lloj balte kemi pasë, kishim të bardhë edhe baltë normale. Ai na e mësoi formësimin, procesin e pjekjes, terjes, ngjyrosjes e deri në përfundimtare. Kjo zgjati pesë ditë. Ne fillum me punu, ishim një grup i

<sup>4</sup> Hannibal Salvaro (1935) artist kroat që punon në qeramikë. Ai studjoi ndërtimtarinë në Univerzitetin e Zagrebit. Nga viti 1958, ai hulumtoi shumë teknika dhe risi në qeramikë në procesin e pjekjes dhe ngjyrosjes së qeramikës.

studentëve, faktikisht studentë kanë qenë krejt edhe fillum me punu. Ka qenë ni kënaqësi tepër e madhe, një përvojë shumë e mirë, shumë e çmueshme, shumë që më ka vyjt bile mu edhe normal të gjithëve se s'ka pasë punëtori të tillë më herët.

**Erëmirë Krasniqi:** Edhe ju si staf jeni kyç edhe jeni zhvillu profesionalisht...

**Lirije Buliqi:** Na me shumë kënaqësi punojshim. Na punojshim edhe u bo atmosferë e punës. Para ndërtesës së Galerisë e patëm bo si punëtori, punojshim tanë ditën deri në mbramje vonë. Pra, ato që i pruni të gatshme na veç i ngjyrosëm edhe i kqyrshim efektet e ngjyrave sesi dalin pas pjekjes së parë. Një teknikë që nuk kom ndi une përpara, teknika raku<sup>5</sup>. Ajo ishte ma e vështira, ka një proces ma të gjatë, por shumë ma të lezetshëm.

Aty fillum me punu edhe furrën e patëm pak të vogël që u dufke disa herë m'i pjekë për me mujt të paktën ka një punim secili artist me e pjekë. Kemi punu edhe momentin kur u kry punëtorja i kemi ekspozu. Tani disa punime u përzgjedhën për me u ekspozu në ekspozita ndërkombëtare. E tash ndër to, unë e kom marrë një shpërblim, Blerta [Syla] ka marrë, ka qenë një grup shumë i suksesshëm. Veprat janë pëlqy edhe janë ekspozu. Artistët shprehën dëshirë me formu shoqatën e qeramikës, sikur qysh ekziston e arteve aplikative. E fillum, por si gjithmonë te na punët mbeten në gjysmë dhe dështoi.

**Erëmirë Krasniqi:** Po de po, por edhe ka qenë moment i mirë për juve me i kombinu aftësitë e juja në skulpturë edhe në qeramikë edhe me kriju punë të reja. A mundësh me më tregu ma shumë për këtë pjesë?

**Lirije Buliqi:** Çka më ka bo mu përshtypje edhe gjithë të tjerëve është procesi i pjekjes në teknikën raku. Për shembull, e punojshim pllakën apo vazon, ajo duhej me u terë në temperaturë të dhomës, pas terjes ajo pjekej. Pra, temperatura ishte 900 shkallë, temperatura duhej me u matë. Mjeshtri që e udhëhiqte punëtorinë i kishte pajisjet; i pjekëm, i ngjyrosëm edhe një pjekje të dytë ua bonëm.

Në fillim ne nuk dishim as m'i kombinu nuansat, se prapë punojshim me do glazura që ne s'i kishim pa kurrë. Unë po flas për veti, por edhe të tjerët për herë të parë i kanë pa. U pjekën, tani e provum teknikën raku. Kishte shumë kombinime, njëqind kombinime të mundshme ishin, me rritë efekte, me përpunu strukturën. Edhe e provum edhe këtë teknikë dhe kjo pak u bo punë ma e zorshme, ma e vështirë për me e realizu.

**Erëmirë Krasniqi:** Tregom ma shumë, si të ka ndihmu me u zhvillu?

<sup>5</sup> Pjekja në teknikën raku është një teknikë e vjetër e qeramikë-bërjes japoneze e cila është përdorur me shekuj. Historia e teknikës raku daton që nga shekulli XVI. Enët tradicionale të punuara me teknikën raku, po ashtu janë përdorur nga mjeshtërit e Zen Buddhismit, të cilëve u pëlqene thejshtësia dhe natyraliteti i tyre.

**Lirije Buliqi:** Unë e pata mundësinë dhe privilegjin që furra mbeti në Galeri. Unë edhe dy herë tjera e mbajta një punëtori me një grup të studentëve, edhe ato për katër-pesë ditë. Tani procesin e pjekjes e bonëm në një periudhë më të gjatë, mandej unë e kom vazhdu temën. Kom punu aq sa kom mujt, në momentin që kom qenë një orë e lirë, për shembull në Galeri e kom shfrytëzu furrën kom dalë, më kanë ndihmu kolegët me një pjekë, edhe me këth furrën në vend. Kom punu mjaft që tash jom e gatshme me pasë edhe ekspozitë personale.

**Erëmirë Krasniqi:** E çka pikturojshe?

**Lirije Buliqi:** Mu ma shumë më kanë tërëhjekë pllakat, domethonë nifarë strukture me bo, qysh kisha material. Për shembull kom përdorë, kom përdorë thesin, për strukturën e thesit ose ndonjë gurë që ka pasë thymje ma interesante ose kom modelu skulpturë, vazo pak me forma kësi të çrregullta që mu më pëlqejnë ma shumë. Kështu që, jom dalë e knaqme që e kom kry se edhe po pëlqena, po pëlqehen punimet prej artistave kolegë.

**Erëmirë Krasniqi:** Po mendoj, si teknikë interesante, se osht' edhe pikturë edhe qasi stili...

**Lirije Buliqi:** Edhe pëhurë, edhe pëlhurën e kom përdorë që osht' e Dukagjinit, jonë këto marhamat [shamitë] e Rugovës që më kanë lone, si femini më kanë lonë qysh me thonë, {shikon në muri} ni, ni shejë...

**Erëmirë Krasniqi:** Përshtypje.

**Lirije Buliqi:** Ni përshtypje të mirë që tash i realizoj, që prapë kisha punu me pasë mundësi (qesh).

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh kanë qenë dhetë vjet e fundit, po mendoj prej pavarësisë e tutje, 2008...

**Lirije Buliqi:** Po mendoj kanë qenë, për mu kanë qenë... se tash gjeneratat e reja, ma shumë po merren me video, me instalacione, me këto që për mua edhe kjo osht' diçka e re edhe shumë tërheqëse qenka. Por, prapë unë jom... ndoshta pse e gjeneratës vjetër pak jam unë ma shumë e brushës se qetyne modeleve tjera. Edhe pse këto jonë shumë të çmushme, shumë kanë imagjinatë, shumë ka artista që e njohin punën e që jonë të talentum, që duhet me u ndihmu e me u vlerësu, e me pasë ndonjë ekspozitë shpërblyse që zakonisht edhe ka. Ka qenë kjo "Artistët e së nesërme" për me shku jashtë me u formësu...

**Erëmirë Krasniqi:** Për rezidencë.

**Lirije Buliqi:** Po, për rezidencë.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Erëmirë Krasniqi:** Tregona për sot jeni pensionu para pak muje, nashta me naj rikapitullu qeto 40 vjet, qysh kanë qenë për ty në Galeri? Ni jetë e lidhun me Galeri...

**Lirije Buliqi:** Për mu, si e kom paramendu jetën e profesionin e krejt, jeta ka marrë kahje tjetër, shumë ma të mirë se që kisha mendu që e boj. Ka qenë një përvojë shumë e mirë dhe e kandshme. Një përvojë që më ka mundësu me u formësu, m'u bo artiste. Kom punu me aq dëshirë që... po mendoj, kom pasë edhe kriza, kom pasë kriza, kom pasë momente të këqija edhe të mira normal. Dikush ka ditë me të çmu, dikush ma shumë, dikush ma pak, por në përgjithësi mirë kom kalu. U pensionova me 4 Maj [2020].

**Erëmirë Krasniqi:** Të këtij viti.

**Lirije Buliqi:** Të këtij vitit. Nuk mundem me thonë që është vështirë, s'është keq. Me rëndësi me pasë shëndetin. E falenderoj stafin e Galerisë dhe të Ministrisë së Kulturës që më përciellën në mënyrë dinjitoze. Përciellja ke e mirë, pak emocionuese, është moment në të cilin gjithkush preket, por jo që e kom përjetu keq, aspak. Kom punu, kom kontribu aq sa kom mujt, kom ndihmu sa kom mujt. Domethonë, kom qenë e hapun për çdo artist, për çfarëdo pune që është dashtë që ka pasë të boj me Galerinë, kom ndihmu, kom dhonë materiale studentave. Besoj që e kom kry punën me përkushtim dhe shpresoj që kom arritë me i ndihmu dikuj.

**Erëmirë Krasniqi:** Shumë faleminderit Liri!

**Lirije Buliqi:** Faleminderit juve që patët kohë, që ma dhatë këtë mundësi me shpreh një përvoj 40 vjeçare. Faleminderës!

**Erëmirë Krasniqi:** Kënaqësi e jemja.